PROJEKTMARRVESHJE PER BASHKIMIN E SHOQERISE TREGTARE MEME "G.P.G. COMPANY" sh.p.k ME SHOQERINE BIJE ""VELLEZERIT-TOLA" sh.p.k

E lidhur sot me me date 16.10.2020,ndermjet shoqerise tregtare meme "**G.P.G. COMPANY**" sh.p.k, perfaqesuar nga perfaqesuesi ligjor z.Paqsor Buzi dhe shoqerise bije "**VELLEZERIT-TOLA**" sh.p.k, perfaqesuar nga perfaqesuesi ligjor z.Gezim Dani, te cilet duke deshiruar rritjen e performances tregtare te shoqerive te tyre nepermjet riorganizimit, te bazuar ne kerkesat ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ne nenet 214-226 te tij dhe ne statutet e dy shoqerive,

kanë rëne dakort sa vijon:

Forma dhe drejtimi i bashkimit

a) **Bashkimin me perthithje** te shoqerise meme "G.P.G. COMPANY" sh.p.k, me shoqerine bije "VELLEZERIT-TOLA" sh.p.k, me ane te se ciles ortaket presin te realizojne perfitime me te medha ekonomike, nga perqendrimi i burimeve financiare, permiresimi i menaxhimit, ulja e kostove te administrimit etj.

b) **Drejtimi bashkimit** ne kete operacion do te jete; shoqeria meme "G.P.G. COMPANY" sh.p.k, shoqeria perthithese, e shenuar ne vijim edhe si shoqeria perfituese e kontributeve, ndersa "VELLEZERIT-TOLA" sh.p.k, shoqeria e perthithur, e shenuar ne vijim shoqeria kontribuese.

Permbajtja e termave te projekt marrveshjes sipas kerkesave të nenit 216 dhe 225 te ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" duke qene se jemi ne kushtet e nenit 225 "Bashkimi me perthithje ne raste te vecanta",, pika 2, ku shoqeria meme "GPG Company" zoteron 100% te kapitaleve te shoqerise bije "VELLEZERIT-TOLA" sh.p.k .

a) Emrat e regjistruar dhe selitë e shoqërive, që marrin pjesë në bashkim.

Shoqëria përthithëse, "GPG Company" sh.p.k .

E themeluar sipas ligjeve te Republikes se Shqipërisë si shoqeri me përgjegjësi të kufizuar dhe e rregjistruar ne Rregjistrin Tregtar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit me date, 16.08.1996, me numrin unik te indentifikimit (NIPT) J64324443V.
Selia e shoqerise eshte ne Lagjja 18 Tetori, godine 1 kateshe,tek nyja e prodhimit Asfalto-Betonit, prane Rotondos se Plukut, Lushnje.
Kaapitali i regjistruar i saj eshte 1.047.270.990 leke, i ndarë në 2 kuota me vlere nominale 523,635,495 leke/kuota dhe zoterohet nga Ortaket:
Paqsor Buzi i cili zoteron 1 kuote, me vleren nominale 523,635,495, ose 50 % te kapitalit.
Gëzim Dani cili zoteron 1 kuote, me vleren nominale 523,635,495, ose 50 % te kapitalit.
Ne kete projekt eshte shoqeri- perthithese.

Shoqëria e përthithur, "VELLEZERIT-TOLA" sh.p.k

E themeluar sipas ligjeve te Republikes se Shqipërisë si shoqeri me përgjegjësi të kufizuar dhe e rregjistruar ne Rregjistrin Tregtar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit me date 12.11.2007, me numrin unik te indentifikimit (NIPT) K73512202L.
Selia e shoqerise eshte Bulevardi Zhan D'Ark, Pallati ngjitur me Ministrine e Jashteme, Kati 7, Tiranë.
Kapitali i regjistruar i saj eshte 100,000 leke, ndarë në 100 pjese me vlere nominale 1,000 leke/pjesadhe zoterohet 100% nga Ortaku i Vetem "G.P.G. COMPANY" sh.p.k,
Ne kete projekt eshte shoqeri- e perthithur.

b) **Të drejtat, që rrjedhin nga kuotat e shoqërisë përthithëse**

Kalimi i kuotave nga shoqeria bije "VELLEZERIT-TOLA" sh.p.k tek shoqeria meme "G.P.G. COMPANY" sh.p.k. nuk shoqerohet me zmadhim te kapitalt, pra pas bashkimit me perthithje, kapitali i shoqerise do te jete ai i shoqerise meme "GPG Company" sh.p.k. qe eshte1.047.270.990 leke, i ndarë në 2 kuota me vlere nominale 523,635,495 leke/kuota dhe zoterohet nga Ortaket Paqsor Buzi dhe Gezim Dani,ne menyre te barabarte nga 50% secili, pasi jane shoqeri te te njejtit grup,jane te njejtet pronare dhe per rrjedhoje do te gezojne te drejta te barabarta edhe ne shoqerine perthithese.
Pas momentit te bashkimit ortaket do te gezojne te gjithe te drejtat qe jep kuota e zoteruar ne baze te ligjeve dhe statutit te shoqerise perthithese qe nga data 01 Janar 2019.

c) **Të drejtat, që shoqëria përthithëse u njeh zotëruesve të kuotave apo të drejtave të veçanta të shoqërive të përthithura apo çdo mase tjetër në favor të tyre.**

Shoqeria "G.P.G. COMPANY" sh.p.k do te jete zoteruese e kontributit te shoqerise "VELLEZERIT-TOLA" sh.p.k, në daten e realizimit perfundimtar te operacionit. Ajo do te gezoje frutet e kontributit duke filluar nga 1 janari 2019 me te njejtat kushte qe gezonin edha para realizimit të bashkimit ne fjale, pasi jane shoqeri te te njejtit grup, ne raportin shoqeria meme zoteron 100% te kapitalit te shoqerise bije..

d) **Përparësitë e veçanta, që u jepen administratorëve, anëtarëve të këshillit të administrimit, këshillit mbikëqyrës apo ekspertëve kontabël të autorizuar.**

Ky operacion bashkimi nuk do të përmbaje as të drejta dhe as ndonjë avantazh të vecantë per ortaket dhe personat qe ushtrojne funksione drejtimi.

e) **Pasojat që bashkimi do të ketë ndaj punëmarrësve e përfaqësuesve të tyre, si dhe masat e propozuara për to.**

Bashkimi nuk do te kete pasoja per te punesuarit e te dy shoqerive. Punemarresit e shoqerise se perthithur qe eshte vetem administratori, do te jete i punesuar te shoqerise perthithese me te njejtat kushte kontraktuale.

Te tjera çeshtje te rena dakort

Duke qene se jemi ne kushtet e bashkimit me perthithje te shoqerise meme si shoqerise meme qe zoteron 100 % te kapitaleve te shoqerise bije qe do te perthithet, mbeshtetur ne nenin 225,pika 2 "shoqeria meme perthithese nuk detyrohet te permbushe kushtet e percaktuara ne nenet 216 pika 1, shkronjat "b", "c" e "d" e 2 dhe neni 217 te ketij ligji.
Gjithashtu, ne kete rast nuk zbatohen as dispozitat a nenit 224 te ketij ligji.

Per sa me lart nuk eshte i nevojshem raporti i eksperteve kontabel.

Ne aspektin e kontabilitetit te gjitha operacionet e veprimtarise te kryera prej shoqerise se perthithur "VELLEZERIT-TOLA" sh.p.k, nga data 1 janar 2019 deri ne daten e realizimit te bashkimit do te konsiderohen si te kryera nga shoqeria perthithese *"G.P.G. COMPANY" sh.p.k* dhe rregjistrimet kontabel perkatese do te merren ne librat e saj.

Projektmarrveshja hartohet ne dy kopje dhe nenshkruhet nga perfaqesuesit ligjor pa vrejtje.

Për shoqërinë "G.P.G. COMPANY" *sh.p.k(perthithese)*
Asambleja e Pergjithshme
(Paqsor Buzi) **(Gëzim Dani)**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
import-export
G.P.G.CO
SH.P.K
NIPT:J64324443V
LUSHNJE - ALBANIA

Për shoqërinë "VELLEZERIT-TOLA" *sh.p.k (e perthithur)*
Ortaku i Vetem "GPG Company" sh.p.k .
Perfaqesuar nga Administratori
(Gëzim Dani)

PRODHIM ENERGJIE
imp-exp
VELLEZERIT
TOLA
sh.p.k
TIRANE - ALBANIA